



KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Kryetari Marko Bislimoski udhëhoqi mbledhjen e 46 të Bordit të Rregullatorëve të Komunitetit Energjetik

Sot, më datë 15 shtator 2020, përmes online platformës, është mbajtur mbledhja e 46 e Bordit të Rregullatorëve të Komunitetit Energjetik (ECRB), me të cilin udhëhoqi Marko Bislimoski, kryetar i Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit. Në mbledhjen e rregullt të vjeshtës, rregullatorët e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Gjorgjisë, Kosovës, Moldavisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Ukrainës, biseduan për sfidat, me të cilat ballafaqohen sa i përket furnizimit stabil dhe të sigurtë të energjisë në kohë pandemie, si dhe realizimin e reformave energjetike në kushte të jashtëzakonshme.

Shoku primar nga kriza shëndetësore ka kaluar, sektori energjetik është gati edhe për periudhën e dimrit që vijon - deklaroi kryetari Bislimoski. Në fjalimin hyrës në fillim të mbledhjes, ai theksoi se Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit, ka hasur në sfida serioze në punën e tij gjatë këtij viti, ka punuar në rrethana të jashtëzakonshme dhe ka qenë ndërmjetësues në krijimin e masave për kategoritë më të ndjeshme të qytetarëve, të goditur nga kriza shëndetësore.

Anëtarët rregullatorë të Komunitetit Energjetik, në mbledhje e mbështetën Komisionin Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që të mos i nënshtrohet presioneve politike të opozitës dhe të vazhdojë me punën e tij profesionale dhe transparente, e cila siguron pavarësi në vendimmarrje.

"Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ka harmonizuar një mekanizëm me kompanitë energjetike, me të cilin qytetarët e goditur nga kriza shëndetësore kanë pasur mundësi të paguajnë faturat nga muajt e krizës në këste dhe pa interes. Njëkohësisht, kemi lëshuar rekomandim deri te kompanitë, që të mos i shkyçin konsumatorët për shkak të mospagimit të faturave për energjinë elektrike, ujin dhe energjinë termike të shpenzuar. Këto biseda janë tema edhe sot- para dimrit. **Sollëm vendim për rritjen e çmimit të energjisë elektrike prej 7,4 %, që mesatarisht, për faturë prej 25 eurosh nënkupton rritje prej 1,85 eurosh. Paralelisht ngritëm iniciativë në koordinim me Komunitetin Energjetik, që të rishikohet mundësia e zgjerimit të përkohshëm të listës së qytetarëve të përfshirë me subvencione për varfëri energjetike, me persona, që janë goditur nga kriza shëndetësore. Por, mendoj se mungon proaktivitet institucional nga autoriteti ekzekutiv dhe ligjdhënës për realizimin e iniciativave dhe propozimeve tona, i cili si duket vjen si rezultat i periudhës së kaluar të zgjedhjeve, pasi institucionet nuk kanë funksionuar plotësisht. Nga ana tjetër, është paraqitur presion nga opozita, e cila në vend se të propozojë zgjidhje në Parlament, kryen presion të paarsyeshëm mbi Komisionin Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit, me protesta të vazhdueshme për ndryshimin e vendimit për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Por, edhe përskaaj presioneve nga protestat politike, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit vazhdon të punojë në mënyrë të përkushtuar, me kapacitet të plotë duke u udhëhequr nga parimet e transparencës dhe përgjegjësisë dhe do t'i qëndrojë besnik pavarësisë së tij të vërtetuar nga Komuniteti European i Energjisë. Periudha e kaluar me krizën shëndetësore na mundësoi të fitojmë përvojë për mbajtjen e stabilitetit të sistemeve energjetike në kohë pandemie. Koordinimi i detajuar në të gjitha kompanitë energjetike përmes formimit të ekipeve kujdestare, por edhe komunikimi i ndërsjellë mes kompanive, është treguar kyç në sigurimin e qëndrueshmërisë së sitemit. Si kryetar i Bordit të Rregullatorëve të Komunitetit Energjetik, jam krenar, që të gjithë trupat rregullatorë e kanë realizuar detyrën e sigurimit të furnizimit të sigurtë dhe stabil të**



energjisë elektrike dhe termike, gazit dhe derivateve të naftës edhe në kushte pandemie. Në këtë kohë, përveç profesionalizmit dhe njohurive, shkathhtësia për organizim të mirë dhe mbrojtja e shëndetit të të punësuarve, ka qenë primare në funksionimin e trupave rregullatorë. Muajt e kaluar mund të konsiderohen si përgatitje për periudhën e dimrit që vijon." deklaroi Bislimoski, kryetar i Bordit të Rregullatorëve të Komunitetit të Energjetikës dhe kryetar i Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Trupat rregullatorë, anëtarë të Komunitetit Energjetik, e kanë përshëndetur vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila me propozim të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit, e ka nominuar operatorin e tregut të energjisë elektrike **si operator të tregut të organizuar të energjisë elektrike** në bursë. **Bëhet fjalë për nominim të parë në këtë segment në vendet anëtare të Komunitetit Energjetik - që është tregues i aktiviteteve reformatore të avansuara në vend.** Komptencë e tij do të jetë edhe bashkimi i tregjeve të energjisë elektrike në vendet e regjionit.

Qëndrimet e përbashkëta të koordinuara të trupave rregullatorë në lidhje me politikën energjetike, harmonizimi i rregullave rregullatore të bashkëpunimit përtej kufijve, si dhe ndarja e njohurive dhe përvojave rregullatore, janë tri shtyllat, në bazë të së cilave referojnë rregullatorët në secilën mbledhje të përbashkët. Në dhjetor të vitit 2019, kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës, Marko Bislimoski, unanimisht u zgjodh si kryetar i Bordit të Rregullatorëve të Komunitetit Energjetik (Energy Community Regulatory Board - ECRB).